



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare

Nr. 02-35/23-06

Prishtinë, më 16 nëntor 2006, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 88 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 19 e 20 tetorit, të 27 tetorit dhe të 3 nëntorit 2006,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për auditimin e brendshëm,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shndërrimin e poseduesve të palujtshmërive private në pronarë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për noterinë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punë,
8. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Regullator të Telekomunikacionit për vitin 2005,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Çështje Gjqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me listën e kandidatëve të propozuar për pozitën e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij,
10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për shëndetësi dhe
11. Shqyrtimi i propozimvendimit për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit.

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë seancë.

1. Miratimi i rendit të ditës

Për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Deputeti **Gjergj Dedaj**, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, kërkoi që në seancën e sotme të debatohet lidhur me vendimin për shtyrjen e zgjidhjes së statusit të Kosovës, si dhe Grupi Negociator ta përfundojë mandatin e tij.

Deputeti **Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, paraqiti dy kërkesa: a) Kuvendi të debatohet për raportin e Komisionit Evropian për çështjen e Kosovës, dhe b) Kuvendi të debatohet për krimet e bëra nga sistemi komunist në Kosovë prej vitit 1945 deri më 1999.

Deputeti **Xhevat Bislimi** (PDK) kërkoi që Kuvendi, në çdo seancë, të debatohet për gjendjen energjetike në vend, ku do të raportonte ministri i Energjetikës para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari tha se, sipas Rregullores së punës të Kuvendit, kërkesat duhet të parashtrihen me shkrim.

Ministri **Jonuz Salihaj** kërkoi që pika gjashtë të shqërtohet pas pikës së tretë, ngase kishte për të udhëtuar jashtë vendit.

Kuvendi miratoi kërkesën e ministrit Jonuz Salihaj.

2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 19 e 20 tetorit, të 27 tetorit dhe të 3 nëntorit 2006

Procesverbalet e seancave plenare të 19 e 20 tetorit, të 27 tetorit dhe të 3 nëntorit 2006 u miratuan pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Nait Hasani** parashtroi pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve lidhur me dëmtimet arkeologjike afër kishës Shën Gjergji në Prizren.

Zëvendësministrja **Angjelina Krasniqi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.

Deputeti **Rifat Krasniq** pyeti ministrin e Transportit dhe të Postelekomunikacionit lidhur ndërtimin e rrugës Mamushë-Piranë.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputeti Krasniqi.

Deputeti **Kamber Kamberi** pyeti ministrin e Shëndetësisë për marrëveshjen ndërmjet ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë lidhur me trajtimin dhe participimin e pacientëve në spitalet e Shqipërisë dhe të Kosovës.

Ministri **Sadik Idrizi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Kamberi.

Deputeti **Genc Gorani** pyeti ministrin e Ekonomisë dhe të Financave sa para i janë paguar bankave private nga thesari i BKK-së, vitin e kaluar, për transferin e të hollave nga kontot private dhe të IPVQ-ve?

Zëvendësministri **Behxhet Brajshori** iu përgjigj pyetjes së deputetit Gorani.

Deputeti **Jakup Krasniqi** pyeti kryeministrin e Kosovës dhe ministrin të Punëve të Brendshme se çka kanë ndërmarrë për zbulimin e vrasjeve me motive politike?

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Krasniqi.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për noterinë

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri, **Jonuz Salihaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim ministri **Salihaj** i paraqiti qëllimet, objektivat dhe mënyrën e zbatimit të këtij projektligji. Ai i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin atë.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Jonuz Salihaj**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ramadan Kelmendi, Nerxhevane Dauti, Naim Maloku, Teuta Sahatqija, Mahir Yagcilar dhe Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 64;

Kundër----- 3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për noterinë.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese – Komision Raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për auditimin e brendshëm

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----69;

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për auditimin e brendshëm.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shndërrimin e poseduesve të palujtshmërive private në pronarë

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja, **Melihate Tërmkolli**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim ministrja Tërmkolli i paraqiti qëllimet, objektivat dhe mënyrën e zbatimit të këtij projektligji. Ajo i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin atë.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministrja Tërmkolli, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nekibe Kelmendi, Nerxhivane Dauti, Ymer Halimi, Teutë Sahatqija, Xhezair Murati dhe Gjegj Dedaj**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 73;

Kundër----- 3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për shndërrimin e poseduesve të palujtshmërive private në pronar.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shërbime Publike dhe Administratë Lokale – Komision Raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punë

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri, **Ibrahim Selmanaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim ministri **Selmanaj** i paraqiti qëllimet, objektivat dhe mënyrën e zbatimit të këtij projektligji. Ai i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin atë.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Selmanaj**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nafije Berisha, Zahrije Jusufi, Zylfije Hundozi, Fatmire Mulhaxha, Shpresa Murati, Sanije Alijaj, Florë Brovina, Ramadan Kelmendi, Naxhije Doçi dhe Milazim Haliti**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 63;

Kundër----- 4.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për punë.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Punë, Shëndetësi dhe Çështje Sociale – Komision Raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së, Alush Gashi, kryesuesi seancën e sotme e deklaroi të mbyllur. Seanca i vazhdon punimet nesër në orën 10:00.

E premte, 17 nëntor 2006

Vazhdim i seancës

Në fillim të seancës ishin të pranishëm 66 deputetë.

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

8. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Regullator të Telekomunikacionit për vitin 2005

Kryesuesi i seancës, **Gazmend Muhaxheri**, e ftoi kryesuesin e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit ta arsyetojë raportin e punës të ART-së për vitin 2005.

Anton Berisha, kryesues i Këshillit të ART-së, paraqiti, para deputetëve të Kuvendit, raportin e vjetor të punës për vitin 2005.

Objektivat kryesorë të ART në vitin 2005, shtoi z. Berisha, ishin vazhdimi i ngritjes së institucionit, në mënyrë të veçantë organizimi i brendshëm konform praktikave dhe standardeve evropiane.

Në rrafshin juridik, përpilimi dhe miratimi i rregulloreve (legjislacionit sekondar), përmes të cilit në mënyrë precize konkretizohen veprimtaritë në sektorin e telekomunikacionit.

Në aspektin rregullator, veprimtaria përmbledhet në proceset e reja licensuese, monitorimin e përmbushjes së kushteve të licensave si dhe sigurimi i vendosjes së ligjshmërisë në sektor. Në mënyrë të veçantë janë me rëndësi oferta referente për interkoneksion, heqja e lakut lokal dhe ribalansimi i tarifave.

Në aspektin e strukturës të brendshme organizative, ART ka filluar procesin e ristrukturimit në bashkëpunim me ekspertë të BERZH, TAIEK (Komisionit Evropian) që ka rezultuar në një model organizativ modern, të bazuar në praktikat rregullatore ndërkombëtare dhe në Ligjin për telekomunikacionin.

Sa u përket aspekteve financiare dhe buxhetore, në vitin 2005, ART ka hyrë në periudhë kalimtare nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, ashtu siç është e paraparë me ligj, në buxhet vetëfinancues, që ka rezultuar në fund të vitit me të hyra prej 10,067,890€ dhe shpenzime në vlerën 504,895.46€. Shuma e mbetur është derdhur në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Meqenëse tani jemi në fund të muajit të dhjetë të vitit 2006, të gjitha projektet e filluara në vitin 2005 janë duke vazhduar në vitin 2006.

Pastaj kryesuesi e hapi debatin parlamentar lidhur me raportin e ART-së.

Deputeti **Ibush Jonuzi**, në emër të Komisionit FunkSIONAL, tha se raporti pasqyron pjesën e realizuar të objektivave të këtij subjekti, të cilin edhe e përkrah,- por në anën tjetër-evidencohen edhe vërejtjet për mungesën e disa aktiviteteve të rëndësishme, për realizimin e të cilave ART-ja e ka mandatin.

Ai paraqiti disa çështje që ART-në e obligon Ligji për telekomunikacion. ART është në rrugë të mbarë për nxjerrjen e udhëzimeve për mbarvajtjen e punëve së saj.

Të gjitha vërejtjet e dhëna në raportin e Komisionit ART-ja duhet t'i ketë parasysh për punën e ardhshme të saj, të bazuaranë Ligjin për telekomunikacion.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se e mbështetin raportin dhe e inkurajojnë ART-në në intensifikim të angazhimeve në kuadër të kompetencave dhe të rekomandimeve të Komisionit FunkSIONAL të Kuvendit të Kosovës.

Ai kërkoi nga Qeveria që t'i japë mbështetje institucionale ART-së.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se ART-në që nga fillimi e deri më tani e kanë përcjellë dobësi të mëdha dhe ndoshta dobësia më e madhe është te Ligji për telekomunikacionin, që nuk ofron konkurrencë të mirëfilltë të tregtisë së lirë mobile për faktin se kërkohen vetëm dy operatorë dhe aty ku janë vetëm dy operatorë nuk mund të flitet për një konkurrencë të mirëfilltë.

Mënyra se si është zhvilluar tenderi për operatorin e dytë të telefonisë mobile dhe si është bërë përzgjedhja e tij, që e ka anuluar UNMIK-u është fakt i mjaftueshëm që Këshilli i ART-së duhet të japë dorëheqje ose Kuvendit ta shkarkojë atë.

Gjylanze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se e përkrah raportin e ART-ja për punën gjatë vitit 2005. Në përgjithësi ne e mbështesim punën e ART-së dhe për punën e mëtejme i propozojmë këto rekomandime:

a) Qeveria ta propozojë anëtarin e pestë të Këshillit të ART-së, b) kërkojmë nga ART t'i ruajë edhe më tej pavarësinë dhe objektivitetin, c) i përkrahim rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për punën e ART-së.

Mbështesim veprimet e deritashme të ART-së në shkyçjen e operatorëve ilegalë të telefonisë mobile.

Deputeti **Genc Gorani**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, tha se në përgjithësi e përkrah funksionimin, veprimin e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit.

Ligji për telekomunikacionin shumë gjëra nuk i ka përkufizuar ndërmjet politikëbërjes dhe zbatimit të saj. Kërkoj që në të ardhmen ART-ja të mos merret me politikëbërje e Ministria të ndërhyjë në fazën e zbatimit.

Në të ardhmen kërkojmë një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet Komisionit FunkSIONAL të Kuvendit dhe ART-së.

E inkurajojmë ART-në, që t'i marrë hapat e duhur, në aspektin e rregullimit të frekuencave, rregullimit të mediave, aty ku është kompetenca e saj, veçanërisht në aspektin e rregullimit të

tregut, që krijohet nga ardhja e teknologjive të reja, si dhe shkyçjen e antenave të operatorëve ilegalë, që veprojnë në territorin e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me raportin e punës së ART-së për vitin 2005 dhanë edhe këta deputetë: **Mahir Yagcilar, Demir Limaj, Brikenda Kryeziu, Naim Maloku, Zef Morina, Hatixhe Hoxha, Gani Koci, Bajrush Xhemajli, Safete Hadërgjonaj, Ramadan Kelmendi, Behxhet Brajshori, Xhevat Bislimi, Xhavit Haliti, Teutë Sahatçiu, Selvije Halimi, Gazmend Muhaxheri, Bajram Rexhepi dhe Saabri Hamiti**, që i janë bashkangjitur transkriptit

Pas përfundimit të këtij debati, kryetari e hodhi në votim raportin e punës së ATR-së për vitin 2005. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----46;
Kundër---- 15.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi raportin e punës të ART-së për vitin 2005 dhe rekomandimet e Komisionit Funkcional lidhur me këtë raport.

Pastaj kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së për shkarkimin e Këshillit të ART-së. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----21;
Kundër----- 24.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës nuk e miratoi kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së për shkarkimin e Këshillit të ART-së.

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me listën e kandidatëve të propozuar për pozitën e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij

Kryetari e ftoi nënkryetarin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, ta paraqesë prozimin Komisionit për Emërimine Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij.

Deputeti **Sadudin Berisha**, në emër të Komisionit, paraqiti raportin dhe rekomandimet e panelit intrvistues lidhur me kandidatët e mundshëm për Avokat të Popullit dhe zëvendës kryesor të tij.

Në vazhdim z. Berisha i paraqiti emrat e kandidatëve për Avokat të Popullit si vijon:

1. Hilmi Jashari,
2. Ibrahim makolli dhe
3. Diana toska.

Për zëvendës kryesor të Avokatit të Popullit:

1. Palë Bala,
2. Habib Hajredini dhe
3. Todoroviq Lubinko.

Deputetja Zllatica Kujungjiq kërkoi që propozimi për Zëvendës të Avokatit të Popullit të shtyhet për seancën e ardhshme me arsyetim se duhen konsultime shtesë lidhur me këtë propozim.

Kuvendi e miratoi propozimin e deputetes Kujungjiq.

Deputetët: Teutë Sahatçiu, Gjylanze Syla, Mahir Yagcila dhe Alush Gashi kërkuan që seanca e sotme t'i shtyjë punimet për një ditë tjetër me arsyetim që të jenë të pranishëm edhe deputetët e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kryetari e deklaroi seancën e sotme të mbyllur në orën 15:15 minuta.

E hënë, 20 nëntor 2006

Vazhdim i seancës

10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për shëndetësi

Kryetari e hapi debatin për raportin e Komisionit për Shëndetësi lidhur me zbatimin e Ligjit për shëndetësi.

Deputeti **Fehmi Vula** (LDK) tha se gjendja shumë e vështirë në shëndetësi nuk është vetëm pasojë e mjeteve të pakta financiare, por edhe e një menaxhimi jo të mirë, duke filluar nga Ministria e deri te njësitë më periferike e shërbimeve shëndetësore.

Komisioni ka marrë vërejtje të shumta në terren për mënyrën e blerjes së barërave, të materialin sanitar dhe të aparaturave të ndryshme, tenderë të ndryshëm, ruajtjen e barërave dhe për distribuimin e tyre. Çmimi i blerjes së barërave me shumicë shpesh ka qenë më i shtrenjtë se çmimi me pakicë.

Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Arsimit duhet të bashkëpunojnë më seriozisht për numrin e madh të diplomave të falsifikuara dhe të licencave të dyshimta.

Ministria duhet t'i decentralizojë disa shërbime të veta. Njëra ndër to është emërimi e jo zgjedhja e drejtorëve të institucioneve shëndetësore pa e konsultuar bazën. Mjetet financiare duhet të sigurohen në sasi dukshëm më të madhe, sidomos për barëra dhe mjete pune. Një menaxhim dhe një organizim më i mirë, në të gjitha nivelet do të siguronte mjete të konsiderueshme.

Deputetja **Zahrije Jusufi** (PDK) tha se gjatë monitorimit në institucionet shëndetësore kemi konstatuar se shkalla e implementimit të ligjit është e ulët dhe se qëllimi i ligjit nuk është plotësuar. Ligji parashikon një numër të madh të dispozitave, që duhet të zbatohen përmes akteve nënligjore, por gjer më tani pak janë nxjerrë. Analiza tregon se zbatimi i ligjit nuk ishte në vëmendjen e duhur të Ministrisë së Shëndetësisë. Përveç Ministrisë së Shëndetësisë edhe Qeveria ka përgjegjësi për implementim të Ligjit.

Numri i urdhërave administrative, të hartuara gjatë vitit, është i vogël dhe i pamjaftueshëm për zbatimin e këtij ligji. Ministria e Shëndetësisë duhet t'i japë prioritet hartimit të akteve nënligjore dhe të harton strategji për tejkalimin e gjendjes.

Në institucionet e shëndetësisë është konstatuar gjendje shumë e rëndë: Në të gjitha institucionet mungojnë barërat e listës esenciale.

Deputetja **Zylfije Hundozi** (AAK) tha se është vlerësim i përgjithshëm se Ligji për shëndetësi po zbatohet pjesërisht, me një pjesë të vogël e tij. Ministria i ka nxjerrë vetëm 30% të akteve nënligjore për zbatimin e ligjit.

Ministria e Shëndetësisë nuk i ka përmbushur disa obligime të rëndësishme, që janë të domosdoshme për funksionimin themelor të shëndetësisë e që dalin nga ky ligj.

Mos rregullimi adekuat i punës në sektorin farmaceutik ,sidomos furnizimi i mangët i institucioneve publike shëndetësore me barna nga lista esenciale.

Sistemi informativ nuk është funksional nga ky sistem është bërë grumbullimi i të dhënave, por jo edhe përpunimi e interpretimi apo analiza e tyre.

Gjer më sot nuk është krijuar një sistem financiar gjithëpërfshirës i sistemit shëndetësor dhe kjo bashkë me keqmenaxhimin e mjeteve financiare ka ndikuar negativisht në sektorin e financimit të kujdesit shëndetësor.

Komisioni ka paraqitur 46 rekomandime, që Ministria e Shëndetësisë duhet t'i zbatojë dhe pas një afati të caktuar ajo duhet t'i raportojë Kuvendit të Kosovës për zbatueshmërinë e këtij ligji.

Deputetja **Teutë Sahatçiu** (ORA) tha se Komisioni ka analizuar zbatimin e ligjit në disa faza dhe ka konstatuar se ai në një pjesë të madhe nuk po zbatohet edhe për shkak të vonesës në përpilimin e akteve nënligjore. Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur që të përmbushë në mënyrë të duhur funksionin e saj në përpilimin e politikave zhvillimore si dhe hartimin, aprovimin dhe zbatimin e infrastrukturës përkatëse ligjore në përputhje me Ligjin e shëndetësisë.

Mosrespektimi i afateve të përcaktuara kohore për fillimin e punës të disa organeve dhe institucioneve të përcaktuara me ligj është brengosës dhe ka pasur pasoja të konsiderueshme në sektorin e shëndetësisë. Kjo vlen veçanërisht për fillimin e funksionimit të Fondit për Sigurime Shëndetësore.

Gjithashtu nuk janë respektuar afatet kohore për fillimin e funksionimit të Këshilli të Përgjithshëm Profesional, por edhe për riorganizimin e QKU-së, si dhe për koordinimin e punëve me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë sa i përket zhvillimit të aktiviteteve mësimore dhe shkencore në institucionet shëndetësore të nivelit të tretë.

Deputeti **Ferid Agani** (PD) tha se është një periudhë e gjatë që jemi duke u ballafaquar me gjendje shumë të vështirë në sektorin e shëndetësisë. Idetë për tejkalimin e kësaj gjendjeje janë dhënë në rekomandimet e komisionit për shëndetësi. Këto rekomandime, janë shumë sistematike gjithëpërfshirëse, por shtroj pyetjen ku janë garantitë se këto rekomandime do të zbatohen së paku një pjesë e vogël e tyre. Ne e dimë se problemi kyç sot i sektorit shëndetësor, përpos menaxhimit të dobët të mjeteve ekzistuese financiare, është edhe financimi tejet i dobët i sistemit shëndetësor. Për këtë edhe Ligji për shëndetësi ka dhënë udhëzimi dhe rrugëdalje - Themelimin e Fondit për sigurime shëndetësore, që do ta zbuste situatën, por nuk do ta zgjidhte problemin.

Ne, në fakt e kemi legalizuar shkeljen e dispozitave ligjore. U deshtë të bëhej greva, u deshtë të mos punonin punëtorët shëndetësorë më shumë se tri javë të dilnin me zgjidhje për problemet me të cilat po ballafaqohet shëndetësia. Kujdestaria ka qenë e paraparë si punë e obligueshme ligjore. Shembulli tjetër e kemi situatën me emërimin e Bordit Ekzekutiv në Q KU, duke mos hyrë fare në nevojën për ndryshimet kadrovike në atë institucion, por bëhet fjalë për një shkelje ligjore.

Sektori i shëndetësisë ka punuar mjaft në vitet e pasluftës dhe punëtorët shëndetësorë kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në këtë drejtim, mirëpo është evidente se serioziteti i institucioneve qeveritare nuk ka qenë në nivel dhe vazhdon të mos jetë edhe tani.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me zbatimin e Ligjit për shëndetësi dhanë edhe këta deputetë: **Naim Jeriliu, Xhezair Murati, Sabri Hamiti, Numan Baliq, Ramadan Kelmendi, Nafije Berisha, Nurishahe Hulaj, Ilaz Pireva, Alush Gashi dhe Behxhet Brajshori**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj vërjetjeve dhe sugjerimeve të deputetëve lidhur me problemet aktuale në fushën e shëndetësisë, si dhe për mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Deputeti **Jakup Krasniqi** tha se Grupi Parlamentar i PDK-së me rastin e votimit të raportit të Komisionit për zbatimin e Ligjit për shëndetësi do të abstenojë, si dhe e arsyetoi qëndrimin e grupit.

Kryetari e hodhi në votim raportin dhe rekomandimet e Komisionit për Shëndetësi për zbatimin e Ligjit për shëndetësi. Rezultatit i votimit ishte si vijon:

Për-----65;
Kundër----0;
Abstenime 21.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash miratoi raportin dhe rekomandimet e Komisionit për Shëndetësi lidhur me zbatimin e Ligjit për shëndetësi.

11. Shqyrtimi i propozimvendimit për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit

Me kërkesë të deputetit **Behxhet Brajshori**, për konsultime ndërmjet IPVQ-ve lidhur me këtë çështje, Kuvend e shtyu shqyrtimin e kësaj pike për një seancë tjetër.

Kryesuesi seancën e deklaroi të mbyllur në orën 12:00.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale